



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivry	18.05.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKMSHUK	2909/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.319/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.319/2022 të datës 04.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike „kontestim konkursi“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.319/2022 e datës 04.04.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 20/KA i datës 31.03.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 12.10.2021 ka shpallur konkursin me numër Referencës: MD/SHKK/03/12.10.2021 për vendin e punës “Zyrtar Korrektues” në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë dhjetë (10) pozita, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili i pa kënaqur me njoftimin e datës 16.02.2022 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve, me datë 11.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 20/KA në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës nxjerr vendim me numër të referencës 20/KA të datës 31.03.2022 me të cilin vendim është refuzuar si e pa bazuar ankesa me numër të protokollit 20/KA e datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

Ankuesi [redacted] i pa kënaqur me Vendimin me numër 20/KA të datës 31.03.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 04.04.2022 parashtron ankesë me numër të protokollit 1795/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 13.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa me datë 19.04.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 04.04.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 11.03.2022 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimi i datës 31.03.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimi i datës 24.02.2022 për emërimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave; Raporti i datës 16.02.2022 për konkursin për zyrtar korrektues; Testi me shkrim; Renditja përfundimtare e kandidatëve për pozitën me numër të referencës MD/SHKK/03/12.10.2021; Lista e kandidatëve të cilët e kanë kaluar intervistën në QP Prishtinë; Lista e kandidatëve të cilët e kanë kaluar testin fizik me datë 06.02.2022; Lista preliminare e kandidatëve të cilët e kanë kaluar testin me shkrim për pozitën zyrtar korrektues; Vendimi i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm i datës 29.12.2021; Vendimi i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm i datës 26.11.2021 për emërimin e komisionit përzgjedhës; Vendimi i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm i datës 14.01.2022; Konkursi i datës 12.10.2021; Vendimi i datës 11.10.2021 për shpallje të konkursit; Kërkesa për fillimin e rekrutimit (Form.MAP-SHCK-01) e datës 07.10.2021; Kërkesa për aprovim të buxhetit e datës 11.10.2021; Vendimi i datës 28.01.2022 i Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Korrektues; Vlerësimet individuale të kandidatëve; Aplikacioni i ankuesit dhe kandidatëve të përzgjedhur me dokumentacionin e bashkangjitur; Provat shtesë të ankuesit të datës 13.04.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe prova shtesë nga organi i punësimit i datës 17.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit [redacted] është e papabazuar *sepe*:

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të*



veçantë", nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji për kategorinë e nëpunësve civil dhe ligjit të veçantë për shërbimin korrektues të përcaktuar sipas nenit 4 paragrafi 2, nën paragrafët 2.1; 2.2; 2.3 dhe 2.4 ku caktohet se: "2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka gjetur se Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 12.10.2021 ka shpallur konkursin me numër të Referencës: MD/SHKK/03/12.10.2021 për vendin e punës "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë dhjetë (10) pozita, bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues të Kosovës.

Sipas konkursit me numër reference MD/SHKK/03/12.10.2021 i shpallur me datë 12.10.2021, për pozitën "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë dhjetë (10) pozita si kërkesa të përgjithshme janë përcaktuar si vijon:

- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm, përkatësisht të mesëm të lartë;
- Të jetë i moshës 18-33 vjeçar (deri në datën e mbylljes së konkursit), etj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar gjashtëqind e njëzet (620) kandidatë, ndërsa katërqind e pesëmbëdhjetë (415) kandidatë i kanë plotësuar kriteret e konkursit për të vazhduar me fazat tjera të testimit, në mesin e tyre edhe ankuesi i cili ka marrë pjesë në fazat e testimit, por nuk është përzgjedhur në listën përfundimtare të kandidatëve fitues nga Komisioni Përzgjedhës sepse nga testi me shkrim dhe me gojë ka arritur të grumbulloj gjithsej 73.7 pikëve të përgjithshme dhe është renditur i njëmbëdhjetë (11) në listën përfundimtare të përzgjedhjes së kandidatëve fitues. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përpilimit të listës së ngushtë ku ka përfshi ankuesin dhe kandidatët e përzgjedhur ka vepruar në pajtim me nenin 8 paragrafin 3 nën paragrafin 3.2 të Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues të Kosovës ku është përcaktuar se: "Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtë do të kontaktohen".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cila e ka kundërshtuar përzgjedhjen e kandidatit me numër të aplikacionit 24 për shkak të kalimit të moshës së caktuar sipas kriterit të konkursit, dhe po ashtu ai pretendon që i plotëson të gjitha kushtet e konkursit dhe kërkon që të hyjë në dhjetëshen e përzgjedhur për të kaluar më tej në fazën e testimit mjekësor dhe të nënshkruaj kontratën.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit [redacted] është i pabazuar sepse Kolegji ka konstatuar se dhjetë (10) kandidatët e pranuar sipas konkursit të datës 12.10.2021 i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit ndërsa sa i përket pretendimit të ankuesit se kandidati me numër të aplikacionit 24 nuk e ka plotësuar kriterin e moshës të kërkuar sipas konkursit të datës 12.10.2021. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të dëshmive të ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar se kandidati me numër të aplikacioni 24 është z. [redacted]

i cili posedon letër njoftimin e datës 09.09.2015 të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Republika e Kosovës, me numër personal 1173212786 dhe me të cilin dëshmohet/vërtetohet se data e lindjes së kandidatit të pranuar është 01.07.1988, dhe që rrjedhimisht kandidati në momentin e aplikimit dhe deri në përzgjedhjen e tij nuk e ka kaluar moshën ashtu siç përcaktohet sipas kriterëve të konkursit dhe Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues të Kosovës, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, po ashtu kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën me numër 154/18 të datës 19.04.2019 të lëshuar nga Kolegji Iliria me të cilën vërtetohet se mbaroi studimet në programin Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe mori titullin Bachelor i Arteve në Banka, Financa dhe Kontabilitet.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke ju referuar fakteve të lartcekura konstaton se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues ka vepruar drejtë dhe në pajtim me dispozitat të Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues të Kosovës përkatësisht nenit 19 ku përcaktohet se *“Kandidati i suksesshëm konsiderohet ai i cili në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka arritur të grumbulloj më se shumti poena por jo më pak se gjashtëdhjetë e pesë përqindë (65 %) të maksimumit të pikëve të caktuara, si dhe kalimin e suksesshëm të vlerësimit shëndetësor”*, në rastin konkret ankuesi është renditur i njëmbëdhjetë (11) në listën përfundimtare, me gjithsejtë 73.7 të pikëve të përgjithshme.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e konkursit me numër të Referencës: MD/SHKK/03/12.10.2021 për vendin e punës *“Zyrtar Korrektues”* në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë dhjetë (10) pozita, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e të Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 20/KA të datës 31.03.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.13/2018 për Procedurën e Rekrutimit të Zyrtarëve Korrektues të Kosovës, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.319/2022

Valentina Kaçandolli Bektashi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.